

**LIGJ**  
**Nr. 8246, datë 1.10.1997**

**PËR INSTITUTIN E INTEGRIMIT TË TË PËRNDJEKURVE**

*(Ndryshuar me ligjin nr.10278, datë 13.5.2010)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr.23/2014, datë 20.3.2014)*

*( I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 16, pika 2 dhe të nenit 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

**KUVENDI POPULLOR**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

*(Ndryshuar me ligjin nr.10278, datë 13.5.2010)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr.23/2014, datë 20.3.2014)*

Instituti i Integrimit të të Përndjekurve (IIP), si institucion shtetëror në varësi të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ka për qëllim të marrë të gjitha masat dhe të ndjekë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish të përndjekurve politikë nga regjimi komunist.”.

**Neni 2**

IIP përpunon dhe trajton çështjet themelore që kanë të bëjnë me të përndjekurit në bashkëpunim me shoqatat e të përndjekurve, duke lidhur për këtë qëllim marrëveshjet përkatëse.

**Neni 3**

*(Ndryshuar me ligjin nr.10278, datë 13.5.2010)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr.23/2014, datë 20.3.2014)*

Struktura dhe organika e IIP-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ndërsa rregullorja e funksionimit të institutit miratohet nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Drejtori i IIP-së emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, pasi merret mendimi i shoqatave të të përndjekurve.

**Neni 4**

*(Ndryshuar me ligjin nr.10278, datë 13.5.2010)*  
*(Ndryshuar me ligjin nr.23/2014, datë 20.3.2014)*

Për të siguruar veprimtarinë e tij, IIP-ja mbështetet në një fond buxhetor, i cili miratohet si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

IIP-ja mund të sigurojë burime financiare edhe nëpërmjet donacioneve e projekteve të ndryshme nga donatorë vendas e të huaj ose edhe nga çdo burim tjetër i ligjshëm.

Të gjitha donacionet ose të ardhurat e tjera të ligjshme, që i vijnë IIP-së, përdoren vetëm për qëllimet, për të cilat është krijuar ky institut.

IIP-ja informon dhe i raporton Ministrin të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për të gjitha të ardhurat financiare që sigurohen nga cilido burim.

#### Neni 5

Përdorimi i të ardhurave të tjera jobuxhetore do të bëhet përmes programeve e projekteve të miratuara nga Këshilli I Ministrave, me propozimin e IIP, pas konsultimeve me shoqatat e të përndjekurve.

Për kontrollin e veprimitarisë financiare të IIP ndiqen të njëjtat rregulla e procedura si për të gjitha degët e tjera të administratës shtetërore.

#### Neni 6

Çdo ligj ose dispozitë tjetër që bien në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitave të këtij ligji, shfuqizohen.

#### Neni 4

##### **Dispozita kalimtare**

*(E parashikuar me ligjin nr.10278, date 13.5.2010)*

Aktet nënligjore, të dala në zbatim të ligjit nr. 8246, datë 1.10.1997 “Për Institutin e Integritimit të të Përndjekurve”, mbeten në fuqi deri në daljen e akteve nënligjore përkatëse, në përputhje me këtë ligj.

Fondi buxhetor, i miratuar për IIP-në, për vitin 2010, mbetet sipas strukturës buxhetore ekzistuese.

#### Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Ligj nr.8246, datë 1.10.1997 shpallur me dekretin nr.1945, datë 6.10.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**  
*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.15, faqe 384*

**Ligj nr.10278, datë 13.5.2010 Shpallur me dekretin nr.6578, datë 25.5.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**  
*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.71, faqe 3179*

**Ligji nr.23/2014, datë 20.3.2014 Shpallur me dekretin nr. 8526, datë 3.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**  
*Botuar në Fletoren Zyrtare nr.47, faqe 1263*